



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 465/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Anullimin e shortit të datës 22.09.2020, për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “*Shërbim me roje private*” – *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.
- Ankimues:** “Dea Security” sh.p.k
Rruga:”Ndre Mjeda”, Qendra Polifunkionale, Kati I, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Insituti i Shëndeti Publik.
Adresa: Rruga “ Aleksandër Moisiu”, nr.80, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.06.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

II.2. Në datën 22.06.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Arbana” sh.a.

00, 0

skualifikuar

2. “Firdeus Security Group” sh.p.k.	00, 0	skualifikuar
3. “Dea Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
4. “Eurogjici security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
5. “Mandi 2K” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
6. “Nazeri 2000” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
7. “S.S.X.” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
8. “SHPSF Snajper Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
9. “Start 2000” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
10. “Toni Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
11. “Trezhnjeva” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
12. “Anakonda Security” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar
13. “Kevenjo” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar

II.4. Në datën 09.06.2020, operatori ekonomik “Dea Security” shpk është njoftuar elektronikisht për për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik “Dea Security” shpk, në datën 13.07.2020 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me anë të shkresës nr. 630/22 prot, datë 17.07.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë.

II.7. Në datën 24.07.2020 operatori ekonomik “Dea Security” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk

II.8. Pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, dokumentacionit bashkëngjitur tij, si dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor, në datën 03.09.2020 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin KPP 353/2020 si vijon:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dea Security” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.9. Në datën 10.09.2020 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve, (duke zbatuar vendimin e mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik 353/2020), si më poshtë vijon:

1. “Arbana” sh.a.	00, 0	skualifikuar
2. “Firdeus Security Group” sh.p.k.	00, 0	skualifikuar
3. “Dea Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
4. “Eurogjici security” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar
5. “Mandi 2K” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
6. “Nazeri 2000” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
7. “S.S.X.” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
8. “SHPSF Snajper Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
9. “Start 2000” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
10. “Toni Security” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar
11. “Trezhnjeva” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar
12. “Anakonda Security” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar
13. “Kevenjo” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar

II.10. Me shkresën Nr. 630/35 Prot, datë 25.09.2020, protokolluar me tonën nr. 353/2 prot, datë 01.10.2020, autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë., njofton se ka zbatuar vendimin K.P.P 353/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

II.11. Nga verifikimet në SPE më datë 10.09.2020, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP 353/2020, duke pasqyruar në raportin e auditit përcaktimet e bëra në të, e më konkretisht duke pasqyruar skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk

II.12. Në këto kushte në datën 1.10.2020 KPP me vendimin Nr. 353/3/2020 ka vendosur:

1. Të pranojë kërkesën e autoritetit kontraktor, Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor ardhur pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr.1175/1 prot, datë 16.10.2020, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1216/2, datë 16.10.2020, si dhe sistemit elektronik të prokurimeve (SPE), rezulton se më datë 21.09.2020 janë njoftuar zyrtarisht të gjithë operatorët e mësipërcituar me vlerë të njëjtë ekonomike se në datë 22.09.2020, ora 14:30 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

II.14. Nga hedhja e shortit të datës 22.09.2020, ora 14:30, në të cilin ishin prezent dhe morën pjesë në short operatorët ekonomik me vlerë të njëjtë “Dea Security” sh.p.k, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” sh.p.k, “S.S.X.” shpk, “Snajper Security” sh.p.k dhe “Start 2000” sh.p.k nga ku rezultoi se:

I renditur në vëndin e parë operatori	“Snajper Security” sh.p.k
I renditur në vëndin e dytë operatori	“Dea Security” sh.p.k
I renditur në vëndin e tretë operatori	“Start 2000” sh.p.k
I renditur në vëndin e katërt operatori	“Nazeri 2000” sh.p.k
I renditur në vëndin e pesë operatori	“Mandi 2K” shpk
I renditur në vëndin e gjashtë operatori	“S.S.X” shpk

II.14. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se më datë 23.09.2020 operatori ekonomik “Dea Security” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

Nëpërmjet kësaj ankese duam të bëjmë prezent një problem që konsiston në shkeljet e kryera nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik për procedurën e prokurimit organizuar në datën 22.06.2020 me objekt "Shërbim me roje private e ambienteve të ISHP- së - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj" si më poshtë:

Nga ana e AK në datën 10.09.2020 në mënyrë elektronike është dërguar njoftim mbi klasifikimin e shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi:

<i>Operatorët ekonomik</i>	<i>Vlera të ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>“Arbana” sha</i>	<i>0.00</i>	<i>PO</i>
<i>“Firdeus Security Group” shpk</i>	<i>0.00</i>	<i>PO</i>
<i>“Dea Security” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>JO</i>
<i>“Mandi 2K” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>JO</i>
<i>“Nazeri 2000” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>JO</i>
<i>“S.S.X” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>JO</i>
<i>“Snajper Security” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>JO</i>
<i>“Start 2000” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>JO</i>
<i>“Anakonda Security” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>PO</i>
<i>“Eurogjici Security” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>PO</i>
<i>“Kevenjo” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>PO</i>
<i>“Toni Security” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>PO</i>
<i>“Trezhnjeva” shpk</i>	<i>6863992.76</i>	<i>PO</i>

Në datën 21.09.2020, në orën 16:15 nga Autoriteti Kontraktor Instituti i Shëndetit Publik Tiranë nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike portalit app ëëë.gov.al në llogarin e përdoruesit në rubrikën kërkesa nga AK na vjen njoftimi”

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____2020

DREJTUAR: *“DEA Security” shpk*
 “Mandi 2K” shpk
 “Snajper Security” shpk
 “START 2000” shpk
 “Nazeri – 2000” shpk
 “S.S.X.”

LËNDA: *Njoftim mbi hedhjen e shortit*

Në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim me roje private” e ambjenteve të ISHP-së, – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit në shumën 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, me numër - REF-59490-06-01-2020, zhvilluar në datë 22.06.2020 ora 10.00, Ju keni të njëjtën vlerë të ofertës ekonomike të paraqitur në këtë procedurë.

Për sa më sipër mbështetur në nenin 66 pika 8 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” fituesi do të shpallet me short në prezencë të ofertuesve.

Shorti do të hidhet në datë 22.09.2020 ora 14.30 në Institutin e Shëndetit Publik.

*Duke ju uruar punë të mbarë,
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*

Së pari, AK duhet të anullojë shortin pasi nuk ka respektuar afatin minimal të lajmërimit të operatorëve ekonomikë i cili sipas udhëzimeve të APP është 24 orë pasi njoftimi për shortin ka ardhur në datën 21.09.2020, ora 16:15 minuta për shortin që do të zhvillohej në datën 22.09.2020, në orën 14:30 minuta.

Afati shumë i shkurtër pa u plothësuar 24 orë për të marrë pjesë në procedurën e shortit ka vënë përpara vështirësive operatorët ekonomikë të cilët do të ishin pjesëmarrës në short.

Së dyti, AK duhet të anullojë shortin i cili nuk u zhvillua në kushtet e duhura dhe sipas përcaktimeve ligjore.

Faza e Parë

Tërheqja e zarfave me numrat përkatës brenda tyre nga 1-6, që do të përcaktonte radhën e tërheqjes.

Faza e dytë

Tërheqja e zarfave me numrat përkatës brenda tyre nga 1-6, ku numri 1 do të përcaktonte fituesin.

Faza e parë u zhvillua në përputhje të plotë me atë që u parashikua dhe nuk pati asnjë kontestim.

Ndërkohë që në fazën e dytë, Komisioni nuk respektoi procedurën për arsye se nuk i ndërroi të gjithë zarfat dhe konfuzoi operatorët ekonomik pasi katër nga gjashtë zarfat që u përdorën për hedhjen e shortit të parë për përzgjedhjen e radhës së tërheqjes u përdoren edhe për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e fituesit. Dy zarfat e tjerë në të cilët do të futeshin numrat për përzgjedhjen e fituesit ishin të ndryshëm (më të rinj, të papërdorur) dhe dalloheshin qartë nga zarfat e tjerë duke bërë që përfaqësuesi i shoqërisë sonë të konfuzohej dhe të ndihej nën presion.

Përfaqësuesi i shoqërisë sonë kërkoi që të mos vijohej me procedurën e tërheqjes pa u ndërruar më parë zarfat, mirëpo Komisioni vendosi të mos respektojë këtë procedurë dhe për këtë arsye shoqëritë pjesëmarrëse përfshi dhe tonën u larguan.

Përfundimisht nga argumentimi i bërë sa më sipër kërkojmë nga ana e Autoritetit të bëhet anulimi i shortit pasi nuk ishte transparent dhe kishte shkelje flagrante në mënyrën e zhvillimit.

Shpresojmë që ankesa jonë të merret në konsideratë, pasi në të kundërt ne do ndjekim të gjitha shkallët e ankimit.

II.15. Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.630/32 prot, datë 25.09.2020 i kthen përgjigje palës ankimuese, duke vendosur mospranimin e ankesës me pretendimet si me poshtë:

Në përgjigje të ankesës suaj më datë 23/09/2020, protokolluar në ISHP me nr. 630/31 prot, datë 23/09/2020, me objekt kundërshtimin e shortit të hedhur nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik më datën 22.09.2020, për përcaktimin e OE të suksesshëm në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim me roje private e ambienteve të ISHP-së - Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj me fond limit në total: 6,864,034.83 (gjashtë

milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e katër pikë 83) lekë pa TVSH, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ky insitucion, pasi shqyrtoi me vëmendje ankesën tuaj, vendosi t'a trajtojë atë bazuar në Kreun III “Kundërshtimi Administrativ”, të Kodit të Procedurave Administrative të RSH.

Sa më sipër, bazuar në nenin 44 të K.Pr.Adm, pasi organi publik shqyrtoi paraprakisht ankesën tuaj,

Vëren:

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, konstatohet se ky OE ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, pasi përmbushen kriteret formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër i parashikuar nga ligji;

Në këto kushte, Instituti i Shëndetit Publik mori në shqyrtim ankesën.

II.

Rrethanat e çështjes

II.1 Në këtë procedurë prokurimi, te zhvilluar nga Instituti i Shëndetit Publik, më datë 22.06.2020, ora 10:00, në SPE kishin paraqitur interes nëpërmjet ofertave të tyre shoqëritë:

- 1. “Anakonda” shpk me nipt K39003551E, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- 2. “Arbana” sh.a. me nipt K21310002U, pa shtojcën e ofertës ekonomike.*
- 3. “DEA Security” sh.p.k me nipt K51521007J, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- 4. “Eurogjici Security” sh.p.k me nipt K31929010K, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH..*
- 5. “Firdeus Security Group” sh.p.k me nipt L22309011R, pa shtojcën e ofertës ekonomike.*
- 6. “Kevenjo” shpk me nipt K363087461, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- 7. “Mandi 2K” shpk me nipt K31707026S, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- 8. “Nazeri 2000” sh.p.k me nipt K31422029Q, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- 9. “S.S.X.” shpk me nipt J618170700, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*
- 10. “Snajper Security” sh.p.k me nipt K77217701L, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.*

11. "START 2000" sh.p.k me nipt K01625002K, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

12. "Toni Security" sh.p.k me nipt K94010201F, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

13. "Trezhnjeva" sh.p.k me nipt K193036050, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave KPP dërgon vendimin me nr.353/2020, datë 03.09.2020, për skualifikimin e OE, "Eurogjici Security" sh.p.k me nipt K31929010K, "Toni Security" sh.p.k me nipt K94010201F, "Trezhnjeva" sh.p.k me nipt K193036050.

Në zbatim të vendimit të KPP, KVO bëri rivlerësimin në SPE më datën 10.09.2020 duke kualifikuar OE si më poshtë:

1. "DEA Security" sh.p.k me nipt K51521007J, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
2. "Mandi 2K" shpk me nipt K31707026S, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
3. "Nazeri 2000" sh.p.k me nipt K31422029Q, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
4. "S.S.X." shpk me nipt J618170700, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
5. "Snajper Security" sh.p.k me nipt K77217701L, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
6. "START 2000" sh.p.k me nipt K01625002K, me çmim total oferte 6,863,992.76 (gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

KVO pas përfundimit të afateve në SPE, vendosi të procedojë me hedhjen e shortit me OE të mbetur në konkurim.

Në datën 21.09.2020 KVO njoftoi në SPE secilin nga OE të kualifikuar për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shortit.

Në datën 22.09.2020, ora 14:30 KVO procedoi me procesin e hedhjes së shortit në prezencë të përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë të kualifikuar:

“Dea Security” sh.p.k	me nipt K51521007J.
“Mandi 2K” shpk	me nipt K31707026S.
“Nazeri 2000” sh.p.k	me nipt K31422029Q.
“S.S.X.” shpk	me nipt J618170700.
“Snajper Security” sh.p.k	me nipt K77217701L.
“START 2000” sh.p.k	me nipt K01625002K.

Nga përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë nuk pati asnjë kundërshtim apo sygjërim për afatin e zhvillimit të procedurës së shortit në orën 14:30, në datën 22.09.2020.

Përfaqësuesi i AK/KVO, pas marrjes së autorizimit të përfaqësimit dhe regjistrimit të ID të përfaqësuesve në procesverbal, mori Palën duke sqaruar OE mbi mënyrën e hedhjes së shortit.

Së pari, u vendos të hidhet 2 shorte një për të përcaktuar rradhën e zgjedhjes së letrave me numër dhe një short për të përzgjedhur fituesi. Kjo ju bë e qartë dhe pjesëmarrësve në short dhe nuk pati kundërshtime nga asnjë pjesëmarrës. Ishin përgatitur 6 numra për shortin e parë të cilët vendosen të zgjedhin sipas renditjes në faqen e APP-së.

Ishin përgatitur edhe 6 numra për shortin e dytë dhe zarfat përkatës.

U vendos që numrat për shortin e parë të futen në zarf, të cilët ju prezantuan si zarfa për t’u parë edhe personave pjesëmarrës në short për të vërtetuar që zarfat ishin bosh dhe to papërdorur. Edhe për këtë fazë nuk pati kundërshtim nga përfaqësuesit e OE .

Numrat 1, 2, 3 deri tek numri 6 pasi u palosën u futën nëpër zarfa të cilat u përzien dhe u hodhën në tavolinë për të tërhequr nga përfaqësuesit e OE, ku numri 1 përfaqëson të parin në renditje, i cili do të zgjedhë i pari, numri 2 të dytin, numri 3 të tretin, etj.

Operatorët ranë dakort që përzgjedhja e shortit të parë të kryhej sipas renditjes në faqen e APP-së.

Operatorët tërhoqën nga një zarf ku rezultoi që renditja për rradhën e tërheqjes së letrave të jetë:

Numrin 1 (një) e mbante “Dea security shpk”

Numrin 2 (dy) e mbante “Snajper Security shpk”

Numrin 3 (tre) e mbante “Nazeri 2000 shpk”

Numrin 4 (katër) e mbante “Start 2000 shpk”

Numrin 5 (pesë) e mbante “SSX shpk”

Numrin 6 (gjashtë) e mbante “Mandi 2 K”

Deri në këtë moment nuk pati asnjë kundërshtim nga përfaqësuesit e OE.

Pasi u përzien nga e para letrat e palosura të cilat kishin të shkruajtura në të numrat: 1, 2, 3 deri tek numri 6, dhe u futën në zarfa, të cilët ju prezantuan përfaqësuesve u hodhën përsëri në tavolinë, u përzien, për t’u tërhequr nga përfaqësuesit e OE pjesëmarrës ku edhe për këtë proces nuk pati kundërshtime nga asnjë nga përfaqësuesit e OE.

Operatorët filluan dhe zgjedhën me rradhën e përcaktuar më lart nga një zarf, ku si pari që e zgjedhi ishte:

I pari në renditjen e mësipërm, sipas shortit të parë ishte “Dea Security” shpk, i cili tërhoqi zarfën ku ishte numri fitues e hapi zarfën dhe lexoi që i kishte rënë numri dy (2).

I dyti në renditjen e mësipërm, sipas shortit të parë ishte “Snajper security” shpk, i cili tërhoqi zarfën ku ishte numri fitues, e hapi zarfën dhe lexoi që i kishte rënë numri një (1).

I treti në renditjen e mësipërme sipas shortit të parë ishte “Nazeri 2000” shpk, i cili nuk pranoi të tërheqi zarfën

I katërti në renditjen e mësipërme, sipas shortit të parë ishte “Start 2000” shpk, i cili tërhoqi zarfën ku ishte numri fitues, e hapi zarfën dhe lexoi që i kishte rënë numri tre (3).

I pesti në renditjen e mësipërme sipas shortit të parë ishte “S.S.X” shpk, i cili refuzoi të tërheqi zarfën, sepse nuk ishte më i intersuar pasi numri 1 (një) i fituesit ishte tërhequr nga operatori ekonomik “Snajper Security” shpk.

I gjashti në renditjen e mësipërme sipas shortit të parë ishte “Mandi 2K” shpk, i cili refuzoi të tërheqi zarfën, sepse nuk ishte më i intersuar pasi numri 1 (një) i fituesit ishte tërhequr nga operatori ekonomik “Snajper Security” shpk.

Për operatorët ekonomikë të cilët refuzuan të tërheqin zarfën, Komisioni vendosi të vazhdonte në mënyrë rastësore të zgjidhte zarfat me numrat e mbetur.

Në përfundim renditja përfundimtare është si më poshtë vijon:

Numrin 1 (një) e mbante “Snajper Security” shpk.

Numrin 2 (dy) e mbante “Dea Security shpk.

Numrin 3 (tre) e mbante “Start 2000” shpk.

Numrin 4 (katër) e mbante “Nazeri 2000” shpk.

Numrin 5 (pesë) e mbante “Mandi 2K” shpk.

Numrin 6 (gjashtë) e mbante “SSX shpk.

Pas përfundimit të tërheqjes së numrave del që fituesi i shortit për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim me roje private” për ISHP-në, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara-me afat 12 muaj”, me fond limit në shumën 6.864.034,83 (gjashtëmilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e tridhjetë e katër pikë 83) lekë pa TVSH do të jetë operatori që ka zgjedhur numrin 1, “Snajper Security” shpk.

III

Autoriteti Kontraktor

Pas verifikimit të ankesës,

1. Në lidhje me pretendimin e orarit AK gjykon se orari nuk pengoi zhvillimin e procedurës së shortit, pasi faktikisht të gjithë OE ishin prezent dhe pjesëmarrës në short në datën dhe në orën e përcaktuar nga AK në njoftim e dërguar në SPE. Përsa më sipër nuk ka arsye përse të anulohet shorti i datës 22.09.2020.

2. Referuar argumentave të ankimuesit dhe dokumentacionit të administruar nga ky autoritet kontraktor, gjykohet se pretendimet e ankimuesit për ripërsëritjen e shortit me argumentat se zarfat e tërhequr ishin të ndryshëm gjatë shortit nuk argumentohet me asnjë provë të dokumentuar. AK referuar dokumentacionit të gjithë procesit konstaton se OE “Dea security” shpk e tërhoqi zarfin pa kundërshtime apo reklamim për llojin e zarfave. AK gjykon se nëse operatori ekonomik ankimues do të vërente ndonjë parregullsi tek zarfat duhet të ngrinte këtë pretendim në momentin e konstatimit dhe mund të kishte kërkuar që zarfat të zëvendësosheshin me të tjera dhe jo pasi shoqëria “Snajper Security” shpk tërhoqi zarfin dhe rezultoi fitues. Operatori ekonomik “Dea Security” shpk u largua nga shorti dhe nuk pranoi të firmosë procesverbalin.

Përsa më sipër, ky autoritet kontraktor,

Vendos

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dea Security” shpk, për këtë procedurë prokurimi.

II.16. Në datën 02.10.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime si ato të ngritura pranë autoritetit kontraktor.

II.17. Nëpërmjet shkresës nr.1175/1 prot, datë 16.10.2020 protokolluar me tonën me nr.1216/2 datë 16.10.2020, me objekt “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Anakonda Security” shpk për anulimin e shortit të datës 22.09.2020 me pretendimin se: **“Së pari, AK duhet të anullojë shortin pasi nuk ka respektuar afatin minimal të lajmërimit të operatorëve ekonomikë i cili sipas udhëzimeve të APP është 24 orë pasi njoftimi për shortin ka ardhur në datën 21.09.2020, ora 16:15 minuta për shortin që do të zhvillohej në datën 22.09.2020, në orën 14:30 minuta.**

Afati shumë i shkurtër pa u plotësuar 24 orë për të marrë pjesë në procedurën e shortit ka vënë përpara vështirësive operatorët ekonomikë të cilët do të ishin pjesmarrës në short.

Së dyti, AK duhet të anullojë shortin i cili nuk u zhvillua në kushtet e duhura dhe sipas përcaktimeve ligjore.

Faza e Parë

Tërheqja e zarfave me numrat përkatës brenda tyre nga 1-6, që do të përcaktonte radhën e tërheqjes.

Faza e dytë

Tërheqja e zarfave me numrat përkatës brenda tyre nga 1-6, ku numri 1 do të përcaktonte fituesin. Faza e parë u zhvillua në përputhje të plotë me atë që u parashikua dhe nuk pati asnjë kontestim. Ndërkohë që në fazën e dytë, Komisioni nuk respektoi procedurën për arsye se nuk i ndërroi të gjithë zarfat dhe konfuzoi operatorët ekonomik pasi katër nga gjashtë zarfat që u përdorën për hedhjen e shortit të parë për përzgjedhjen e radhës së tërheqjes u përdoren edhe për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e fituesit. Dy zarfat e tjerë në të cilët do të futeshin numrat për përzgjedhjen e fituesit ishin të ndryshëm (më të rinj, të papërdorur) dhe dalloheshin qartë nga zarfat e tjerë duke bërë që përfaqësuesi i shoqërisë sonë të konfuzohej dhe të ndihej nën presion. Përfaqësuesi i shoqërisë sonë kërkoi që të mos vijohej me procedurën e tërheqjes pa u ndërruar më parë zarfat, mirëpo Komisioni vendosi të mos respektojë këtë procedurë dhe për këtë arsye shoqëritë pjesëmarrëse përfshi dhe tonën u larguan. Përfundimisht nga argumentimi i bërë sa më sipër kërkojmë nga ana e Autoritetit të bëhet anulimi i shortit pasi nuk ishte transparent dhe kishte shkelje flagrante në mënyrën e zhvillimit. Shpresojmë që ankesa jonë të merret në konsideratë, pasi në të kundërt ne do ndjekim të gjitha shkallët e ankimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Anakonda Security” shpk, për “anullimin e shortit të datës 22.09.2020”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.2. Në VKM -në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 8, është përcaktuar:

- “Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.”

III.1.2. Në Ligjin nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 64/3 është përcaktuar:

1. Palët në proces dhe subjektet e tjera të prekura kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

2. Shqyrtimi i këtij ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat e prokurimit, të lidhjes së kontratës publike të prokurimit të mallrave, shërbimeve apo punëve nga autoriteti kontraktor ose ekzekutimin e detyrimeve, sipas kontratës së prokurimit nga palët respektive.

III.1.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr.1175/1 prot, datë 16.10.2020 protokolluar me tonën me nr.1216/2 datë 16.10.2020, rezulton se në datën 22.09.2020 në orën 14:30 është realizuar hedhja e shortit në ambientet e autoritetit kontraktor në prani të përfaqësuesve të autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë me ofertë të njëjtë , midis tyre dhe operatori ekonomik ankimues “Dea Security” shpk. KPP gjykon se pretendimet e ankimesit për anulimin dhe ripërsëritjen e shortit me argumentat se: “Së pari, AK duhet të anulojë shortin pasi nuk

ka respektuar afatin minimal të lajmërimit të operatorëve ekonomikë i cili sipas udhëzimeve të APP është 24 orë pasi njoftimi për shortin ka ardhur në datën 21.09.2020, ora 16:15 minuta për shortin që do të zhvillohej në datën 22.09.2020, në orën 14:30 minuta, si dhe pretendimi se: Ndërkohë që në fazën e dytë, Komisioni nuk respektoi procedurën për arsye se nuk i ndërroi të gjithë zarfat dhe konfuzoi operatorët ekonomik pasi katër nga gjashtë zarfat që u përdorën për hedhjen e shortit të parë për përzgjedhjen e radhës së tërheqjes u përdoren edhe për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e fituesit. Dy zarfat e tjerë në të cilët do të futeshin numrat për përzgjedhjen e fituesit ishin të ndryshëm (më të rinj, të papërdorur) dhe dalloheshin qartë nga zarfat e tjerë duke bërë që përfaqesuesi i shoqërisë sonë të konfuzohej dhe të ndihej nën presion.”), janë të pabazuara dhe nuk përbëjnë shkak për anulimin e shortit të datës 22.09.2020, ora 14:30, pasi referuar informacionit të sipërpërmendur të autoritetit kontraktor rezulton se për procesin e hedhjes së shortit është mbajtur procesverbali përkatës, ku nga shqyrtimi i tij konstatohet se jo vetëm që përfaqesuesi i ankimuesit ka qënë pjesëmarrës në short, por dhe në fazën e dytë të hedhjes së shortit nuk ka patur kontestime lidhur me zarfat e përdorur për përzgjedhjen e fituesit. Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik referuar procesverbalit të mbajtur nga autoriteti kontraktor në prani të ofertuesve pjesëmarrës në short gjykon se procedura është zhvilluar e rregullt dhe nuk ka shkak për anulimin e saj, pasi në procesverbalin e datës 22.09.2020, nuk është ngritur asnjë pretendim nga operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi mënyrën e hedhjes së shortit dhe akoma më tej procesverbali rezulton i firmosur përveç se nga anëtarët e komisionit edhe nga operatorët e tjerë ekonomik pjesëmarrës, ndonëse përfaqesuesi i ankimuesit ka refuzuar të firmosë atë.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se në rastin konkret ankimuesit i mungon interesi i ligjshëm për të ankimuar hedhjen e shortit nga autoriteti kontraktor në kushtet kur vetë ky operator ekonomik pohon se mori pjesë në short e vërtetuar kjo nëpërmjet procesverbalit të datë 22.09.2020.

Komisioni sqaron se organizimi i shortit është në diskrecion të plotë të autoritetit kontraktor mjafton që të respektohen hapat proceduralë për njoftimin e rregullt të ofertesve për t'u dhënë atyre mundësi të marrin pjesë në procedurën e hedhjes së shortit në mënyrë që të garantohet transparenca dhe barazia në trajtimin e ofertuesve. Komisioni nuk eidenton dhe nuk gjen shkakqe në ankesë për parregullsi në hedhjen e shortit nga ana e autoritetit kontraktor që të mund të legjitimojë ankimuesin në pretendimet e ngritura në ankesë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” shpk nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri;

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me

afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1216 Protokoli, Datë 02.10.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri